

112 - vjetori i lindjes së Lasgushit



Bibliografia
 e Lasgush
 Poradecit,
 bibliografi
 që nuk
 shteron...

Lexoni në faqen 3-4

Dhuna është
KRIM!
 Familje pa
DHUNE -
 Shoqëri në
PAQE!

Lexoni në faqen 7, 8, 9, 10, 11, 12



Falas me gazetën, kalendari i shoqatës "Unë, Gruaja"

Aktualitet

**NJË VEPËR - DËSHMI,
 ME "SIMOTRA" TË
 RRALLA!**



Promovohet libri "Ali Kuçi: Fenomen gjenial i rezistencës Antinaziste", me autor Gjelok Marko

Lexoni në faqen 5-6

Rruga e jetës



Oliger Merko, vazhdon të krijojë

Lexoni në faqen 13

Suplement
16 ditë fushatë kundër dhunës ndaj gruas

faqe 7-12



Vazhdon mbështetja e BE për shoqërinë civile në Shqipëri

Genci Pasko, Drejtues i Projektit TACSO, zyra e Shqipërisë, jep lajmin se Projekti TACSO ka marrë edhe një mandat të dytë nga Komisioni Evropian.

"Ky mandat, shprehet ai, demonstroi edhe njëherë mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet e IPAs, si pjesë e rëndësishme e realizimit të proceseve demokratike dhe kryerjes së reformave për integrimin në Bashkimin Evropian."

Në kuadër të rivlerësimit të nevojave e sfidave me të cilat përballen Organizatat e Shoqërisë Civile në Shqipëri, dhe për t'u njohur më mirë me prioritetet e tyre për dy vitet e ardhshme, TACSO Albania organizoi një seri takimesh konsultative me organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët lokalë në tre rajone kryesore të Shqipërisë, Durrës, Korçë dhe Shkodër. Në këto takime, ekipi i Projektit TACSO prezantoi arritjet

e fazës së parë të projektit dhe shpjegoi fushat kryesore në të cilat do të fokusohet gjatë mandatit të dytë.

Këto takime ishin të parat që filluan një dialog konstruktiv ndërmjet OSHC-ve, përfaqësuesve të pushtetit lokal dhe ekipit të projektit TACSO.

Përsa i përket adresimit të çështjeve institucionale, organizatat pjesëmarrëse në këto takime ngritën nevojën për të avokuar në përpjekjet lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor e fiskal për OJF-të në Shqipëri që mbetet edhe çështja më shqetësuese e ngritur në të gjitha takimet e realizuara.

Si e tillë, TACSO do të ndërmarrë hapa të mëtejshme, në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së në Tiranë për të çuar përpara këtë proces nëpërmjet organizimit të evenimenteve të përbashkëta si p.sh. evenimenti për Përfituesit Individualë nën

Programin P2P që do të organizohet në Shqipëri e që do të fokusohet në mënyrë specifike në këtë problem.

TACSO gjithashtu do të ofrojë rritje kapacitësh për OSHC-të që të njohin e trajtojnë efektivisht çështjet e kuadrit ligjor për OSHC-të, si dhe për ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm.

Gjatë fazës së dytë Projekti TACSO do të vijojë të asistojë Agjensinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile përmes organizimit të aktiviteteve të përbashkëta me qëllim lehtësimin e dialogut ndërmjet këtij institucioni, OSHC-ve dhe qeverisë.

Gjithashtu, evenimente të ndryshme për krijime rrjetesh e shkëmbime përvojash do të nxisin bashkëpunimin me vende të tjera të rajonit, të mësuarit e vepruarit, bazuar në histori suksesi të cilat do të organizohen në Shqipëri, dhe në nivel rajonal.

Korresp. Nositi

Fushat e Operimit dhe Prioritetet e Projektit TACSO 2

Objektivi i projektit mbetet i njëjtë:

Fuqizimi i shoqërisë civile në kuadrin e një demokracie gjithëpjesëmarrëse, mbështetja për qendrueshmërinë e OSHC-ve, nxitja e një mjedisi kulturor e miqësor ndërmjet organizatave të shoqërisë civile, si dhe forcimi i kapaciteteve të përgjithshme dhe përgjegjshmërisë së OSHC-ve në vendet përfituese të Ballkanit Perëndimor dhe Turqi.

Në fazën e dytë, fokusi i punës do të jetë:

* Krijimi dhe forcimi i partneriteteve mes OSHC-ve në nivel sektorial, kombëtar dhe rajonal, si dhe

krijimi i lidhjeve, i kontakteve dhe i veprimeve të përbashkëta brenda vendit dhe në nivel ndërkufitar.

* Adresimi i çështjeve dhe politikave shqetësuese për sektorin jo-qeveritar.

Një gjë e tillë do të realizohet përmes realizimit të konferencave rajonale fushatave sensibilizuese, udhëtimeve familjarizuese dhe iniciativave të tjera të ngjashme.

* Forcimi i kapaciteteve të organizatave të vogla dhe atyre që operojnë në zonat rurale, përmes zgjerimit të bashkëpunimit duke

përdorur intershipet, mentorimin, dhe marrëveshje të tjera bashkëpunuese mes organizatave të vogla dhe atyre me përvojë.

* Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve dhe institucioneve qeverisëse në nivel qendror dhe lokal, si dhe me sektorin e biznesit, duke u dhënë mundësi këtyre aktorëve të marrin pjesë në aktivitetet e realizuara nga Projekti TACSO.

* Zhvillimi dhe zbatimi i plotë i "strategjisë së daljes" dhe sigurimi i qendrueshmërisë së shërbimeve të TACSOs në të ardhmen.

Trajnim mbi Kuadrin Fiskal dhe Ligjor për Organizatat e Shoqërisë Civile

Pogradec, -Ky trajnim u organizua nga TACSO (Asistencë Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile) zyra e Shqipërisë dhe kishte si qëllim të prezantojë OSHC vendore me Sistemin Fiskal që rregullon marrëdhëniet e tyre me Autoritetet Fiskale, duke iu shpjeguar gjithashtu dhe të Drejtat e Detyrimet e tyre përfshirë në këtë rregullim.

Znj. Esmeralda Balluku, këshilltare pranë TACSO-s Shqipëri, theksoi objektivin e përgjithshëm të këtij trajnimi – forcimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile si një garanci për cilësi më të lartë të shërbimeve të tyre përmes dhënies së informacionit të saktë mbi Sistemin Fiskal në Shqipëri.

Ajo informoi pjesëmarrësit për procedurat fiskale, duke përfshirë edhe parimet e administratës tatimore në Shqipëri.

Ekspertja vazhdoi më tej me një përmbledhje të të Drejtave dhe Detyrimeve të taksapaguesve nga sektori jo-qeveritar, duke pranuar diskutimin e gjerë e bërë nga OSHC të ndryshme për këtë çështje. Ajo vijoi me prezantimin e ligjit nr. 8788, i datës 7.05.2011 "Për Organizatat jo fitimprurëse" duke i shpjeguar pjesëmarrësve të gjitha taksat që aplikohen për OSHC-të në Shqipëri.

Ajo gjithashtu informoi përfaqësuesit e OSHC-ve me tatimin mbi të ardhurat, TVSH-në, sigurimet shoqërore dhe taksat e tjera të aplikueshme, si dhe nxori në pah rastet e veçanta ku OSHC-të përjashtohen nga taksat.

Ky prezantim përfshiu gjithashtu taksat vendore, taksat mbi pasurinë, pasuritë e patundshme, ndërtesat në qoftë se janë në pronësi të OSHC-ve, etj.

Ky trajnim shërbeu si një mundësi e mirë për diskutime dhe shkëmbime eksperience mes pjesëmarrësve dhe më kryesorja si një ushtrim dhe azhormim me më të rejtat e Sistemit Fiskal për OSHC-të në Shqipëri.

Ky aktivitet ishte me interes të madh si dhe nxiti shumë komente e diskutime mes 30 pjesëmarrësve nga Qarku i Korçës.



Liriku i liqerit

Në nderim të lirikut të madh, poetit Lasgush Poradeci, në 112-vjetorin e tij të lindjes, Zyra Arsimore në Pogradec organizoi në fund të dhjetorit 2011, një veprimtari kulturore, ku u përkujtua jeta dhe vepra e poetit të liqerit. Aktiviteti mbante firmën e drejtores së këtij institucioni zonjës Eva Çollaku.

Pedagogë të Universitetit të Korçës, studjues dhe poetë, folën për krijimtarinë e Lasgushit, bibliografinë e tij, që nuk shteron, simbolikën e poezisë, veçorinë e ligjërimit poetik, botën lasgushiane dhe letërkëmbimin e poetit me mikun dhe prozatorin e shquar, Mitrush Kuteli. Ligjëratat u mbajtën nga Jovan Basho, Bardhi Hyka, Liri Seitllari, Neli Naço, Albina Pajo, Ilir Shyta, Manjola Vasili dhe Budjon Xhelo.

Pas dokumentarit për Lasgushin, të pranishmit ndoqën një koncert të fjalës artistike, me vjersha të përzgjedhura nga vepra e tij, kujtime nga bashkëkohës të poetit, si dhe një ekspozitë të piktorëve T. Mato, A. Kostandini, S. Lako e G. Zeka, me motive nga jeta dhe vepra e poetit. Interesant në këtë pavion kujtimesh, mbetej albumi fotografive të poetit realizuar nga mjeshtri Niko Tona. Testamenti poetik i poetit "...dhe t'a shoh të pasqyruar/vetëveten fije-fije/fije-fije poezije/që mban erë Shqipërie" ishte simbioza e gjithë aktivitetit.

Llazar Gusho, i njohur në letrat shqipe me emrin letrar Lasgush Poradeci, ka lindur në Pogradec më 1896. Studimet e shkollës së mesme ai i kreu në Manastir e Athinë, dhe më pas studjoi në Bukuresht në vitin 1921, e në Grac të Austrisë në vitin 1924.

Në vitin 1933, u botua vëllimi i tij poetik "Vallja e yjve" dhe më 1937, përmbledhja e dytë "Ylli i zemrës". Veç lëvrimit të poezisë, poeti shqipëroi, me një nivel të lartë artistik pjesë nga krijimtaria e poetëve botërorë si Eminesku, Miçkieviç, Brehet etj. I fundmi i simbolistëve europianë Lasgush Poradeci, vdiq më 1987 dhe sot Pallati i Kulturës Pogradec mban emrin e poetit të madh shqiptar.

DR. ILIR SHYTA

Bibliografia e Lasgush Poradecit, bibliografi që nuk shteron...

Lasgush Poradeci në vitin 1933, në Rumani, falë altruzimit kutelian atje, i botohet vëllimi i tij i parë poetik "Vallja e yjve" dhe katër vjet më vonë, më 1937 i botohet vëllimi i dytë poetik "Ylli i zemrës".

Krijimtaria e Poradecit u publikua kryesisht në shtypin e viteve '20 të shekullit të XX dhe më tej, në këtë mijëvjeçar të ri në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Amerikë etj. Madje një pjesë e tyre vijnë të përkthyer në anglisht, italisht dhe frëngjisht si për të plotësuar një amanet të Çabejit të madh kur shkruan: "Një ditë Shqipëria, do t'ia falë njëherë botës këtë talent të madh..." Tjetër pjesë e rëndësishme e krijimtarisë së tij, janë publicistika dhe ditarët personalë.

Bibliografia krijon një ide solide, sa më të plotë rreth personalitetit individual krijues të autorit. Me këtë ide është hedhur njëherazi edhe guri themeltar i etapave të caktuara brenda të cilave hulumton më tej Teoria e Letërsisë. Pra, gjithçka që ekziston rreth autorit dhe veprës letrare, e pasqyruar në botimet e ndryshme të shpërndara ndër vite, duhet të përmbledhet në një vështrim bibliografik të arsyetuar. Me qëllimin e vetëm, për ta përqendruar informacionin kulturologjik dhe për



1983) ai thekson: "Më vështirë është t'i interpretosh interpretimet se t'i interpretosh gjërat..."

Rugova u hap rrugën më tej bibliografive të tjera, të këtij lloji, jo vetëm në Shqipëri.

Këto janë refleksione të drejtpërdrejta apo tërthore për Lasgush Poradecin, në botime të ndryshme, në vende të ndryshme, e pse jo edhe në lëvrime gjuhësh të ndryshme (doktoratura), që në fakt do t'i jepnin informacionin e duhur për analizë, Historisë së Letërsisë Shqipe, që të gjykojë faktorët se përse vepra ka lënë gjurmë në kohë specifike dhe është njëtrajtësuar në këtë hapësirë kulturore.

Kjo është lista e organeve të periodikut, në të cilin është botuar vepra letrare dhe intervistat e Lasgush Poradecit (1922-2009).

Dodona; Djalëria; Mbleta; Shqipëria e Re; Dielli; Gazeta e Re; Studenti Shqiptar; Ora; Arbëria; Gazeta Shqiptare, Vullneti; Neo-Shqiptarizma; Vullneti i Popullit; Shqiptarja, Demokracia; Kosova; Gazeta e Tiranës; Minerva; Shtypi; Illyria; Kuvendi Kombëtar; Vatra e Rinisë; Përpyekja Shqiptare; Shkëndija; Bota e Re; Rinia Fashiste; Tomori; Tomori i Vogël; Njeriu; Drita; Kombi; Letërsia Jonë, Nëntori; Zëri i Popullit; Jeta e Re; Zëri i Rinisë; Studime Filologjike; Les Lettres Albanaises; Pionieri; Zëri i Vlorës; Fjala;

(...vijon në faqen 4)

ta shndërruar atë në një komunikim sa më efikas.

Për t'i dhënë trajtë më saktë. Duke bërë edhe njëfarë rezymeje pasqyruese indirekte të gjuhës së shtypit dhe frazeologjisë ndër vite, për t'u dhënë liri dhe kursim kohe të gjithëve. Madje, për të kompletuar mënyrën e trajtimit shkencor letrar të informacionit rreth autorit, të cilin studiuesi është duke e trajtuar në bibliografi me të vetmin qëllim, për ta bërë të zotërueshëm dhe të plotë.

Trajtesa të kësaj natyre hulumtimi shkencor nuk janë të panjohura në vendin tonë. Ibrahim Rugova ngelet pionieri i parë i kësaj metode për bibliografinë e arsyetuar. Në "Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare (1504-

Bibliografia e Lasgush Poradecit, bibliografi që nuk shteron...

(...vijon nga faqja 3)

Rilindja; Pararoja; Puna; Filizat; Luftëtari; Atdheu; Shpresa; Finoku; Kushtrim Brezash; Korça; Gëzimi; Rilindja Demokratike; Demokracia; Borëbardha; Nositi; Dardania; Teuta; Revista Letrare; Evropa; Populli Po; Lajmi i Ditës, Sirena e Vogël; Republika; Ushtria dhe Koha; Mer Licht!; Liqeri, Për Mëmëdhenë; Albania; Klan; Bota Ime; 55; Diaspora Shqiptare; Aleph; Glossa; Stil '97; Mokra; Përmeti; Aks; Jehona e Karadakut; Tema; Diella; Panorama; Korrieri; ABC; Shekulli; Kalendari Letrar; Milosao; Poeteka; Pena; Express; Tirana observer, Ndryshe; Gaia;

Titujt dokumentojnë gjithçka duke arshivuar me këtë akt, një pjesë me vlerë të veçantë në kulturën letrare. Bibliografia ekziston sikur copat e gurit formatojnë një mozaik të vetëm, me të gjitha publikimet që kanë të bëjnë me Lasgushin, duke na përfutur pamjen tërësore të atij informacioni të gjerë, që do të na nevojitej konkretisht për poetin, në mënyrë që të komunikojmë me imazhin tërësor të saj.

Bibliografia e veprës së L. Poradecit konsiston e ndërtuar

sipas kësaj strukture:

1. Vepra të botuara të Lasgush Poradecit

2. Vepra dorëshkrim të Lasgush Poradecit

Lexuesi, në horizonte të ndryshme pritëse ka shfaqur gjithëherë dëshirën për ta pasur veprën e Poradecit në dorë. Përgjithësisht ajo ka munguar në intervale kohore për shkak të tirazhit të vogël, shtypur në Rumani, "inJORIMIT" që i bëri diktatura enveriste në vitet e saj, apo prej mosbotimit të familjarëve të poetit pas viteve '90. Vetëm Kosova, atëherë krahinë autonome e Jugosllavisë prezantoi botime speciale të veprës së poetit.

Kështu, në vitet 1932-1939 vëllimet poetike të Lasgushit do të botohen në Rumani, për t'u sjellë në Shqipëri në kohën e Mbretërisë së Zogut. Madje kemi edhe një botim tjetër në Rumani, në vitin 1946. Eshtë fjala për "Misioni i shqiptarëve të Bukureshtit dhe Naim Frashëri". Fjala e Lasgush Poradecit, ish sekretar i përgjithshëm i kolonisë mbajtur me rastin e 100-vjetorit të lindjes së poetit.

Periodha komuniste e boton veprën e poetit të censuruar vetëm tri herë, konkretisht në vitet '60, '74 dhe '90.

Ndërkohë Kosova rrit përmasat e Lasgushit. Nën kujdesin e Sabri Hamitit kemi katër botime të plota, cilësore të lirikave në vitet '68, '78, '86 dhe '90. Demokracia në vend për afro nëntë vjet nuk mundëson asnjë botim të veprës së poetit. Vetëm më 1999, botohen tri veprat letrare, nga një ent privat si "Onufri", për të vijuar me vitet 2002, 2005, 2009 dhe 2010 në shtëpi të tjera botuese private, një pjesë e tyre ribotim.

Kjo situatë është pak a shumë e ngjashme përsa u përket edhe pjesëve të veprës letrare të Lasgushit, të botuar në

periodikë shqiptarë në vitet 1922-2009. Periudha e Monarkisë Shqiptare dhe ajo gjatë dy luftave botërore do të kenë të ekspozuar në vitrinën e shtypit, copëza nga poezitë e Lasgushit. Vitet e pasqirimit të vendit, nga viti '44 deri në 1975 nuk do të kenë asnjë varg të publikuar. Egërsimi i bishës totalitare do të rinisë, dhe në këtë kohë do të botohen me pikatore poezitë e poetit të "harruar" qysh në gjallje të tij. Përsa i përket kësaj pjese letrare, mund të themi që vetëm pas vitit '90, ajo meritoi skeptrin mbretëror të princit të talentuar letrar.

Vitet '90 e këtej, dëshmojnë një gjeografi të re të mendimit kritik, përshfaqur në libra dhe periodikë të ndryshëm. Prezantohen lirshëm, kështu analiza dhe vlerësime sintezë, pikërisht në kohën më të përshatshme, të mundshme...

Ndërkaq, le të shohim edhe kronologjinë e përgjithshme në vite të librave, shkrimeve apo artikujve të tjerëve për L. Poradecin.

Në vitin 1928 kemi të botuar vetëm një shkrim, i cili do të pasohet nga shkrime të tjera sporadikë, për veprën letrare të tij... Kësaj periudhe i takon studimi brilant i Mitrush Kutelit, "Ylli i zemrës, prej Lasgush Poradecit". Aty, Kuteli do të përfundonte me dëshirën e mirë të atij që shkruan disa radhë, drejt një analize më të imët dhe më të plotë të veprës së Lasgushit.

"... në u zgjat dhe kaq kjo i detyrohet vetëm e vetëm artit mjeshtër të veprës lasgushjane.

Lasgushi shfaqet dhe mbetet një kulm vigan, i cili ka për të zotëruar shumë kohë me hijen e vet, literaturën dhe mendimin shqiptar".

Periodha mes dy luftave botërore, sërish do të mbetet e vakët, përsa u përket shkrimeve konstatonjëse apo kritike në krijimtarinë lasgushjane.

Dhjetëvjeçari i Shqipërisë së lirë 1945-1955, do ta fshijë fare nga faqja e dheut, mendimin kritik për veprën e Poradecit. Në vitin '56 do të kemi një të tillë, më pas luhatje botimesh deri në vitin '67.



Në kohën e dikaturës komuniste në këtë vend, përsëri zërat e shkrimeve apo librave të ndryshëm për veprën e lirikut do të jenë të pakëta, dy, tre, katër...

Në këtë model, bën një përjashtim vetëm, viti 1979, me 9 zëra bibliografikë. Fundi i sistemit komunist shqiptar dhe ardhja e erës së ndryshimeve, pas vitit 1990 solli edhe shumësinë e mendimit kritik të botuar, brenda dhe jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë. Mesatarja shkon 10 deri 13 syrrëshë. Në krye të klasifikimit qëndron viti 2000, me 55, pasuar, nga 2003-shi, 2005-sa dhe 2006-ta.

Ndërkaq duhet thënë se bibliografia deri në vitin 2010 është shtuar edhe me 230 zëra të tjerë, konkretisht të tipit të tjerët për Lasgushin.

Poezia lasgushjane në thelbin e vet sendërtues mbetet përherë magji, pikturë dhe muzikë liqeri. Kjo vërehet në ide, mesazhe dhe imazhe, që ajo lë pas duke u vendosur në konekstin e duhur vlerësonjës të shqipes, përgjithësisht. Vlerësimi i kësaj ane artistike të prekshme në kuptimin letrar si gjendje apo vizion, luan një rol primar për të fokusuar të gjitha planet e përfaqësimit të autorit, në rastin konkret të Poradecit, poetit të liqerit, apo shtërgut të fundit që e deshi këtë vend më shumë se çdo njëri prej nesh.

Ilir SHYTA

LASGUSH PORADECI
Bibliografi e arsyetuar



Pogradec -Promovohet libri "Ali Kuçi: Fenomen gjenial i rezistencës Antinaziste", me autor Gjelok Marko

-të çajmë përpara përmes vdekjes dhe harresës, drejt jetës dhe së vërtetës-

Ky libër është vetëm maja e një ajsbergu, një paraqitje e zvogëluar dhe në asnjë mënyrë e plotë e një figure kaq të shquar të rezistencës Antinaziste të popullit shqiptar.

Emri i Ali Kuçit është i njohur, i cituar dhe ka vendin e tij të padiskutueshëm në arkivat, në listat e dokumenteve themelore në mes të studiuesve e specialistëve të historisë në universitetet më të njohura si edhe në institucionet ndërkombëtare, që merren me studimin e dokumentimit e fakteve rreth Luftës së Dytë Botërore, e sidomos të Holokaustit (Shoas).

Shkrimet e Ali Kuçit e libra që flasin për figurën e tij janë botuar e ribotohen edhe sot nga universitete të njohura, p.sh. para pak kohësh nga Universitetet e New York e të Philadelfias në USA.

E, megjithatë, emri i Ali Kuçit ishte i panjohur për mua, për brezin e intelektualëve shqiptarë të

diplomuar në Shqipëri, si dhe për gjithë masën e rinisë e të inteligjencës shqiptare në përgjithësi.

Materialet e këtij libri janë nxjerrë tërësisht nga arkiva e burime dokumentare jashtë Shqipërisë.

Puna për shkrimin e këtij libri më ka bërë të ec përmes fakteve e realiteteve të tmerrshme, ka qenë një rrugë përmes errësirës e tmerrit të vdekjes, një rrugë ku fytyra e veprat e errësirës e të vdekjes pasqyrohen në anën e tyre më të egër. Kjo është edhe arsyeja që libri përmban edhe faqe, fakte, dokumente, të cilat nuk do t'i rekomandoja të lexohen nga të miturit apo edhe nga personat që nuk janë në gjendje t'u bëjnë ballë këtyre fakteve e skenave.

Nuk do t'u rekomandoja leximin e këtij libri në orët e thella të natës.

Gjelok Marko

Gjelok Marko u lind më 10. 05. 1962. Arsimin fillor e të mesëm i kreu në Pogradec.

Në vitet 1981-1985 kreu studimet në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë dega Gjuhë-Letërsi. Nga viti 1985-1991 punoi mësues në shkollën e mesme në Velçan të rrethit të Pogradecit.

Ka bashkëpunuar me revistën "Hosteni", ndërsa studimet e tij kritike të kësaj kohe kanë të bëjnë me romanin satirik. Studimet e tij kritike filluan me temën për mbrojtjen e diplomës dhe vazhduan më tej në kuadrin e kualifikimit pasuniversitar me synimin për të marrë titullin, "Kandidat i Shkencave". Në kuadrin e këtij programi ai ka dhënë provimet pasuniversitare të Filozofisë dhe ka mbrojtur edhe gjuhën angleze.

Që nga viti 1992 ka jetuar kryesisht në Gjermani. Gjatë kësaj kohe ai është marrë me studime historike e biblike. Objekt i studimeve të tij historike kanë qenë periudha e Mesjetës së hershme dhe të vonë, si edhe periudha e Luftës së Dytë Botërore, frut i të cilave është edhe ky libër i parë biografik për Ali Kuçin.

Gjelok Marko ka njohuri të thella për gjuhën angleze e gjermane, njeh gjithashtu gjuhën italiane, serbe, kroate, ruse e greke. Nga gjuhët e vjetra krahas latinishtes gjatë studimeve universitare, ka filluar të studiojë në mënyrë veti edhe greqishten e vjetër e latinishten.



NJË VEPËR - DËSHMI, ME "SIMOTRA" TË RRALLA!

Akademik KOPI KYÇYKU

Më pat thënë para një viti a më shumë që ishte duke mbledhur dokumente me zellin e një blete që ndalet lule më lule. Mënyra se si ma paraqitte projektin, a, më saktë, paraprojektin e vet, ishte krejt e ndryshme nga të zakonshmet. Ishte i përshkuar i tëri, tej e tej, nga një besim i palëkundur se ishte përfshirë në valët e një misioni sa human, gjithaq shkencor e sidomos atdhetar. Kishte për të përshkuar një terren të vështirë, që duhej

pastruar nga egjri e nga mbeturinat e çdo lloji, për të nxjerrë në dritë të vërtetën. Arit i duhej hequr balta. Kaq do të mjaftonte që ai të ndriçonte me të njëjtën forcë. Retrospektiva historike pas shtatë dekadash është jo vetëm e nevojshme, por edhe e vetvetishme, si kërkesë për të verifikuar, riafirmuar apo korrigjuar disa opinione, që qarkullojnë rëndom nëpër libra, artikuj, ese etj, të hedhura në letër apo të pasqyruara në ekran nga specialistë të mirëfilltë, apo thjesht nga kurreshtarë amatorë. Të gjitha lexohen e vështrohen, madje me ëndje, nga një numur lexuesish e

shikueshish në rritje të pandalshme, që rrok të gjitha moshat, kategoritë shoqërore, nivelet e profesionet. Por pakkush syresh e vret mendjen për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura. Ajo që i tërheq, që i bën për vete, është mënyra se si janë shtjelluar ngjarjet, aspekti sensacional, befasitë e të papriturat. Pra, janë të prirur e ua ka ënda ta shohin e ta shijojnë historinë si një vepër letrarë - artistike. Kuptohet që edhe kjo ka rëndësi, se ndryshe është të ndodhesh përpara rreshtimit "të ftohtë" të elementeve që përbëjnë objektin e një evenimenti historik apo të një figure

të shquar, e ndryshe të kesh të bësh me veshjen e së vërtetës me mjete artistike e me figura stilistike të zgjedhura, të cilat jo vetëm nuk ia cënojnë autenticitetin, por, përkundrazi, e nxjerrin atë në pah me elegancë dhe hijeshi. Pikërisht këtë ia ka dalë mbanë të realizojë Gjelok Marko me monografinë e vet "Ali Kuçi: fenomen gjenial i rezistencës antinaziste" (DIJA Poradeci, 2011). Ndodhemi përballë një veprë, që, falë mundit, kompetencës, përkushtimit dhe seriozitetit të autorit, na shpalos një jetë vetëmohuese të një heroji deri tani të panjohur, i cili i bën nder jo vetëm kombit shqiptar, nga i të cilit ka dalë, por mbarë qëndresës antinaziste të njerëzimit.

Pamje nga promovimi i librit në ambientet e shkollës "M. Çollaku", Pogradec



-Shënime për librin "Ali Kuçi: fenomen gjenial i rezistencës antinaziste" shkruar nga Gjelok Marko

Ilir Buzali

Fill pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, pasoi një letërsi e tërë kushtuar krimeve naziste në kampet e përqëndrimit. Për vite me radhë u publikuan libra artistikë, dokumentarë, ditarë, memuare etj. Para syve të gjithë botës u shfaq një nga skenat më tragjike dhe makabre të historisë, me përmasa të tilla sa që edhe sot pas gati 70 vitesh mbeten ende skuta të panjohura, të mbetura në terrin e harresës.

Libri "Ali Kuçi: fenomen gjenial i rezistencës antinaziste" shkruar nga Gjelok Marko sjell një këndvështrim origjinal të një prej figurave shqiptare më të diskutuara të Luftës së Dytë Botërore. Ali Kuçi ka qenë spiun i nazistëve apo antinazist? Ky libër është një sfidë për opinionin negativ që ka ekzistuar tek ne se ai ka qenë një shërbëtor i nazistëve gjermanë. Madje edhe kur nga Gjermania është dërguar kërkesa për të plotësuar dokumentacionin e Ali Kuçit si i internuar në kampet e përqëndrimit, nga ana e Komitetit të Veteranëve ka shkuar një listë ku emri i tij nuk përfshihet.

Autori ka zgjedhur një mënyrë të besueshme dhe origjinale për të hedhur dritë dhe për të bërë rivlerësimin e Ali Kuçit: është mbështetur tërësisht në arkivat gjermane, në ditarët e Ali Kuçit dhe bashkëpunëtorëve të tij në Komitetin Ndërkombëtar të të burgosurve, që ishte ngritur në kampin famëkeq të Dachaut. Më tej ka marrë edhe një dëshmi nga Shqipëria, nga veterani i luftës Xhafer Peçi. Këto e plotësojnë kuadrin e provave, që kemi të bëjmë me një figurë të shquar të frontit antinazist, që i bën nder Shqipërisë.

Libri fillon me një udhëtim në hapësirë, nga Kuçi i Kurveleshit, me traditat e tij, deri në kampin më famëkeq nazist, atë të Dachaut; vijon me një udhëtim në kohë, nga e sotmja, tek vitet e Luftës së Dytë Botërore. Autori duke u interesuar për 120 shqiptarët e internuar në Dachau, rastësisht është ndeshur me emrin e një shqiptari të panjohur për të, por edhe për shumë nga ne.

Për të kuptuar përmasat e tij

duhet thënë paraprakisht se bëhet fjalë për një qytet të vërtetë prej rreth 32 mijë të burgosurish, që ishte bërë shkolla e mundimit dhe torturave për të gjitha kampet e tjera naziste. Shqiptari Ali Kuçi bëhet një nga anëtarët e Komitetit Drejtues të të burgosurve. Kjo shihet qartë në ditarët e ruajtur në arkivin e këtij kampi, që autori ia përcjell besnikërisht lexuesit:

"Brenda një kohe kaq të shkurtër, ne nuk mund të krijojmë struktura të reja me emra të rinj. Kjo do të sillte keqkuptime e anarki. Prandaj duhen përdorur strukturat e vjetra, emrat e vjetër, madje dhe gjuha gjermane, pasi urdhërat e dhëna në këtë gjuhë kuptohen nga të gjithë të burgosurit, pavarësisht nga kombësia e tyre.

Duhen krijuar organe legjislative, trupa gjykues, duhen organizuar gjyqe për të gjykuar e për të vendosur për dënimin që meritojnë tradhtarët, vrasësit në radhët tona. Duhet planifikuar sistemi i furnizimit, gatimit e i shpërndarjes së ushqimit, duhet organizuar shërbimi informativ, etj."

Duket se në grupin organizativ Ali Kuçi ka luajtur një rol kyç, duke mbajtur dhe vendin e drejtuesit të zyrës së shtypit. Me një autoritet të padiskutueshëm, por edhe me modestinë që dallohet në mënyrën e përshkrimit të ngjarjeve, ai në ditarin e tij nuk e ndan veten nga organizatorët e tjerë: "Njëri pas tjetrit ne i gjetëm bashkëluftëtarët tanë. Për të ruajtur sekretin u përpoqëm që ky grup të ishte sa më i vogël në numër. Sa vetë na duhen? 8; 10? Po, 10 vetë mjaftojnë. Secili prej tyre është besnik. Secili prej tyre, po të vinte çasti vendimtar ishte në gjendje të organizonte menjëherë mijëra vetë."

Me aktivitetin e tij ai kontribuoi në shpëtimin e jetës së 32 mijë të burgosurve. Interesante janë momentet kur përshkruhet takimi i tij me të burgosur në gjendje të

rënduar, ose që jetojnë çastet e fundit dhe ai u jep kurajo e shpresë se liria nuk është e largët. Ali Kuçi në përshkrimet e tij sjell me një vërtetësi rrëqethëse pamje dhe skena makabre dhe mizore, të torturave çnjerëzore: "Vagonat që transportojnë të vdekurit mbushen gjithmonë e më plot. Brenda këtyre vagonave si edhe në paradhomat e krematoriumit është një skëterrë e vërtetë. Mjekët nazistë shpesh urdhërojnë të transportohen për të djegur, jo vetëm të vdekurit, por edhe shumë që janë ende gjallë. Të gjallët e të vdekurit palosen mbi njëri-tjetrin si stiva me dru."


Libri ka dy aspekte të rëndësishme: rivlerësimin e personalitetit të Ali Kuçit dhe ndërgjegjësimin për rrezikun e nazizmit. Vetiu pasi përfundon së lexuari këtë libër, të lind një pyetje e thjeshtë: A e vlen të merremi tani pas gati 70 vitesh, me kampet e përqëndrimit? Mund të japim si përgjigje dy argumente të thjeshtë. Së pari, asnjëherë s'është vonë për të hedhur dritë mbi figura historike që lartësojnë dinjitetin dhe emrin e një populli të tërë, që ata përfaqësojnë. Së dyti, kujtojmë gazetarin e dëgjuar çek Julius Fuçik. Ai u arrestua nga nazistët dhe përfundoi i varur në litar. Gjatë kohës së burgimit ai shkroi në fshehtësi, në letra cigaresh një libër të tërë me mbresa, përshkrime e përsiatje, të titulluar "Reportazh me litar në grykë". Julius Fuçik është autor i thirrjes së famshme antinaziste: "Njerëz, ju dua, qëndroni vigjilentë".

Vigjilentë? Tani në shekullin e 21-të? Po. Jo më larg se para disa muajsh, në korrik të këtij viti, një i ri 32-vjeçar norvegjez vrau në ishullin e Utojes më tepër se 70 të rinj nga vende të

ndryshme të botës që ishin grumbulluar në një shkollë vere. Një masakër e vërtetë që të kujton krimet naziste. Nazizmin dhe Hitlerin ta kujtojnë edhe idetë e tij raciste, fashiste, madje edhe antishqiptare, të hedhura në manifestin prej 1500 faqesh. Por Anders Breivik kishte dhe fiksimin për t'i ngjarë liderit të tij shpirtëror edhe në pamjen e jashtme, duke i dhënë portretit të tij imazhin e racës ariane. Në manifestin e tij ai shkruan se "ka situata ku mizoria është e nevojshme" dhe se "është më mirë për të vvarë shumë". Dhe Anders Breivik nuk është një rast i vetëm. Ndaj libri "Ali Kuçi: fenomen gjenial i rezistencës antinaziste" shkruar nga Gjelok Marko dhe botuar nga shtëpia botuese "DIJA- Poradeci" është aktual. Ai mbetet një dokument i rëndësishëm e me vlerë që lartëson figurën e një shqiptari të madh në humanizmin e tij, Ali Kuçit. Është meritë e autorit Gj. Marko që i nxitur nga ndjenja e shqiptarizmit, pasi "takohet" për herë të parë me A. Kuçin në arkivat gjermane, me punë këmbëngulëse rivlerëson një shqiptar të shquar, që i bën nder vendit të vet.



Dhuna është KRIM! Familje pa DHUNE - Shoqëri në PAQE!



Duke filluar nga 25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare Kundër Dhunës ndaj Gruas, deri më 10 Dhjetor, Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, njerëz dhe organizata në të gjithë botën janë bashkë me mesazhe dhe aktivitete të përbashkëta, në mbrojtje të të drejtave të grave, si pjesë e të drejtave të njeriut.

Shoqata "Unë, Gruaja" për 11 vjet rresht, është bërë pjesë e Fushatës dhe ka kontribuar për sensibilizimin e komunitetit në rajonin Pogradec-Korçë për dhunën sistematike që shkel dinjitetin dhe personalitetin e gruas, duke u përpjekur t'i bëjë bashkë të gjithë aktorët e individët e interesuar për t'i thënë JO këtij krimi. Edhe këtë vit "Unë, Gruaja" do të organizojë një sërë aktivitete dhe në disa prej tyre do të bashkëpunojë me Zyrën për Barazi Gjinore dhe kundër Dhunës ndaj Gruas në Bashkinë Pogradec, me mësues e nxënës, me organizatat lokale të qytetit tonë, si dhe me individë të tjerë të përkushtuar si në qytet ashtu edhe në zonat rurale.

Shoqata "Unë, Gruaja" ju fton të bëheni pjesë e Fushatës për t'i thënë ndal dhunës ndaj Gruas!

Një shoqëri e barabartë nga pikpamja gjinore, është një shoqëri e bazuar tek respekti. Ajo është një shoqëri, në të cilën gra e burra kanë vlera të barabarta dhe shikohen si individë, jo si anëtarë të njërit apo tjetrit seks.

Në një shoqëri të tillë gjithësecili, si burra dhe gra arsimohen, punojnë, kujdesen për fëmijët dhe sigurojnë jetesën.

Në një shoqëri të barabartë nga pikpamja gjinore, një burrë dhe një grua janë thjesht dy individë, me shanse, të drejta dhe përgjegjësi të barabarta. Në një shoqëri të tillë nuk ka dhunim, nuk ka keqtrajtimit, nuk ka abuzim.



Kjo fjongo lejla është simbol i përpjekjeve të përbashkëta kundër dhunës ndaj gruas. Ne ju inkurajojmë ta mbani këtë simbol në shenjë solidariteti me ne.

Ne aspirojmë për një botë humane, ku njerëzit, pavarësisht nga diversiteti dhe seksi, kanë mundësi të njëjta, janë njësoj të lirë të vendosin për jetën e tyre.

Ne mbështesim njerëzit në përpjekjet që ata bëjnë për të fituar dhe mbrojtur të drejtat e tyre njerëzore.

Ne duam të jemi qytetarë të një bote pa dhunë, të jetojmë në një familje dhe shoqëri pa dhunë.



25 nëntor - 10 dhjetor, 2011

Për të shqyrtuar më në thellësi disa nga struktura sociale, që nxisin dhe promovojnë dhunë ndaj grave dhe vajzave, vitin e kaluar Qendra e Grave për Leadership Global (CWGL) lançoi një fushatë shumëvjeçare me temë: “Në kryqëzimet e militarizmit dhe të dhunës ndaj grave”. Ndërkohë që ka shumë mënyra të ndryshme për të përcaktuar militarizimin, përkufizimi i punës tonë e paraqet militarizmi si një ideologji që krijon një kulturë të frikës dhe mbështet përdorimin e dhunës, agresionit, ose ndërhyrjet ushtarake për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe zbatimin e interesave ekonomike dhe politike. Militarizmi gjithashtu privilegjon forma të caktuara të dhunshme të mashkulloritetit, i cili shpesh ka pasojë të rënda për sigurinë e grave, të njerëzve burrave të cilët nuk përshtaten me këto role, dhe të shoqërisë si një e tërë. Ngjarjet e tanishme botërore - duke përfshirë edhe ndërhyrjet ushtarake, sulmet ndaj civilëve që marrin pjesë në ndryshime politike, konfliktet e vazhdueshme etj -ilustrojnë me shembull mënyrën e veçantë në të cilën militarizmi ndikon se si ne i shohim fqinjët tanë, familjet tona, jetën tonë publike dhe njerëz të tjerë në botë . Një aktiviste nga Mozambiku shprehu shqetësimin e saj se nuk mund të ketë “Paqe në Tokë,

ndërkohë që ka luftë në shtëpi. “Komentet e saj spikatën, dhe ne shpresojmë se tema e këtij viti përshkruan marrëdhëniet komplekse mes paqes në shtëpi dhe në botë, dhe njeh shumë hapësira ku militarizmi ndikon në jetën tonë. Prandaj, tema për vitin 2011 do të jetë:

**Nga paqja në shtëpi, tek paqja në botë!
Le të sfidojmë militarizmin dhe t'i japim fund Dhunës ndaj Grave!**

Duke ndërtuar të dhënat e mbledhura nga pjesëmarrësit gjatë fushatës 2010, për këtë vit 16 Ditët e fushatës do të gjurmohet më tej në pesë çështje që janë identifikuar si prioritet për ata që punojnë në kryqëzimet e dhunës ndaj grave dhe militarizmi. Duke sjellë së bashku gratë, paqen dhe të drejtat e njeriut për të sfiduar lëvizjet e militarizmit, për dekada me radhë, lëvizjet e grave, lëvizjet për të drejtat e njeriut, dhe lëvizjet paqësore kanë lobuar për përdorimin e strategjive paqësore për t'i dhënë fund konfliktit dhe dhunës dhe për të arritur të drejtat e grave. Këto lëvizje sfidojnë strukturat shoqërore që lejojnë dhunën dhe diskriminimin të vazhdojë. Përderisa ne mund të kemi qasje të ndryshme për të sjellë një botë më të drejtë, avokimit në të gjitha këto zona është i lidhur në vetvete me

sfidën për militarizmin dhe për të vënë përpara një alternativë feministe. Shoqëria civile luan një rol vendimtar në nxitjen për të kuptuarit të sigurisë. Ka shumë mjete ndërkombëtare dhe mekanizma që mund të na ndihmojnë për të detyruar qeveritë tona të jenë përgjegjëse për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave (p.sh. Platformën e Pekinit për Veprim, CEDAW, e Drejta Ndërkombëtare Humanitare, Këshilli i të Drejtave të Njeriut, Rezolutat e Këshillit të Sigurimit 1325, 1820, 1888, 1889 , 1960 për Gruan, Paqen etj.)

Përhapja e armëve të vogla dhe roli i tyre në dhunën në familje:

Dhunë në familje është një realitet në çdo vend të botës. Kjo dhunë bëhet edhe më e rrezikshme kur armët janë të pranishme në shtëpi, pasi ato mund të përdoren për të kërcënuar, plagosur apo vrarë gra dhe fëmijë. Sipas Rrjetit Ndërkombëtar të Veprimit për Armët e Vogla (IANSAs) gratë kanë tri herë më shumë gjasa të vdesin në mënyrë të dhunshme në qoftë se ka një armë në shtëpi. Armët e vogla janë gjithashtu një nga shkaqet kryesore të viktimitave civile në konfliktet moderne. Jo vetëm që armët e vogla lehtësojnë dhunën ndaj grave, por për shkak të shoqërimit të tyre me dhunën mashkullore, ato shpesh sjellin

dhunë në vetvete. Pa marrë parasysh kontekstin -konflikt apo paqe, prania e armëve pa dallim ka të njëjtin efekt: Më shumë armë do të thotë rrezik më shumë për gratë. Rrjedhimisht, këtë vit ne do të shikojmë tregëtinë e armëve dhe keqpërdorimin e armëve të vogla.

Dhunë seksuale në dhe pas konfliktit: Përdhunimi është përdorur shpesh si një taktikë lufte për të drejtuar frikën dhe për të fyer apo ndëshkuar gratë dhe komunitetet e

tyre. Dhuna seksuale në konflikt dhe situata pas konflikteve është përdorur për të përforcuar hierarkitë gjinore dhe politike. Ndërsa ka pasur më shumë vëmendje për këtë krim në vitet e fundit, dhuna seksuale mbetet një pengesë e madhe për sigurinë e grave dhe ri-integrimin, pasi efektet e saj janë shkatëruese si fizikisht, psikologjikisht dhe nga ana shoqërore.

Dhunë politike kundër grave, përfshirë dhunën e zgjedhjeve:

Përdorimi i dhunës për të arritur qëllimet politike, ka implikime të veçanta gjinore. Nga dhuna elektorale zgjedhore që synon femrat me dhunën e ngacmimit seksual të protestuesve femra dhe kandidateve politike, tregon hapur shkelje të të drejtave njerëzore të grave . Edhe kur gratë luajnë role të rëndësishme në revolucionet paqësore, mund të përjashtohen nga rolet politike në qeverinë e re. Qeveritë që përdorin forcën kundër civilëve të tyre, pezullojnë sundimin e ligjit në një periudhë të “jashtëzakonshme” apo përdorin ligjeve të “anti-terrorizmit” për të shtypur lëvizjet pro-demokracisë, ose për të heshtur mbrojtësit e të drejtave të njeriut e të punësojnë militantistë të ideologjive që përpiqen t'i përmbahen dhunës si masë "sigurie".

Dhunë seksuale dhe gjinore të kryera nga agjentët e shtetit, veçanërisht të policisë apo të ushtrisë:

Edhe në vende ku nuk ka konflikte të njohura, ndodh dhunë ushtarake kundër civilëve nga ana e personelit me uniformë. Militarizmi ka tendencë të privilegjojë një formë të veçantë të mashkulloritetit agresiv dhe dhuna seksuale është një mjet që mund të përdoret për të kërkuar pushtet mbi të tjerët. Individët në pozitat e autoritetit mund të besojnë se ata mund të kryejnë krime pa u ndëshkuar dhe kjo është ilustruar nga shkalla e lartë e dhunës seksuale në ushtri, kërcënime nga policia



Nëse viktimat e dhunës në familje kanë vetëbesim të ulët, kjo mund t'i bëjë ata të qëndrojnë në një marrëdhënie abuzive.

për gratë të cilat raportojnë raste të dhunës apo sulmit, shkeljet e kryera nga forcat paqeruajtëse, dhe dhuna kundër grave që jetojnë dhe punojnë rreth bazave ushtarake. Gjatë viteve të ardhshme, CWGL do të punojë për të mbështetur zhvillimin e koordinimeve, të një kritike globale, feministe e militarizmit dhe të dhunës të përhershme. Fushata e vitit 2011 është një mundësi për reflektim dhe biseda në lidhje me çfarë mund të bëjnë lëvizjet globale të drejtave të grave për të sfiduar strukturat që lejojnë dhunën ndaj grave, për të vazhduar në të gjitha nivelet, nga lokale në globale. Ajo është gjithashtu një kohë vendimtare për të arritur të përfshijë më shumë burra, djem, bazuar në besim dhe liderë tradicionalë, dhe partnerë të tjerë të rëndësishëm në këtë punë drejt ndërtimit të një bote më të drejtë dhe paqësore. Ndërsa është diskutuar shpesh militarizmi në kuptimin e situatave të konfliktit, kjo temë fushate kërkon të zgjerojë të kuptuarit tonë të militarizmit i cili ndikon në shumë mënyra në jetën tonë të përditshme. Një aspekt i rëndësishëm i fushatës 16 Ditët përfshin dëgjimin e historive të grave në mbarë botën duke qëndruar në solidaritet me njëri-tjetrin, por ajo gjithashtu thekson rëndësinë e punës në nivel lokal për të transformuar mendimet e dhunshme apo militante. Duke u fokusuar në atë se si “paqja në shtëpi” shtrihet jashtë dhe ka të bëjë me “paqen në botë,” ne shohim se si vlerat e padhunshme mund të ndikojnë në qëndrimet e miqve, familjeve, komuniteteve, qeverive dhe aktorëve e tjerë. Si gjithmonë, CWGL inkurajon aktivistët për të shfrytëzuar 16 ditët e Fushatës të përqëndrohen në çështjet që janë më të rëndësishme për kontekstin e tyre lokale. Në të njëjtën kohë, ne gjithashtu shpresojmë që ju do të gjeni mënyra për të lidhur me temën ndërkombëtare dhe do të punoni në solidaritet me aktivistët e tjerë nëpër botë. 16 ditët e aktivizimit kundër Dhunës Gjinore është një fushatë ndërkombëtare me origjinë nga Instituti Global i Grave për Leadership i sponsorizuar nga Qendra për Leadership Global i Grave (CWGL) në Rutgers University në vitin 1991. Janë zgjedhur datat 25 nëntor, Dita Ndërkombëtare Kundër Dhunës ndaj Grave dhe 10 Dhjetor, Dita Ndërkombëtare të Drejtat e Njeriut, në mënyrë që simbolikisht të bëjnë lidhjen ndërmjet dhunës ndaj grave dhe të drejtave të njeriut dhe për të theksuar se dhuna e tillë është një shkelje e të drejtave të njeriut.

Vetë-respekti dhe dhuna në familje

Në shumë raste, vetë-respekti dhe dhuna në familje shkojnë dorë për dorë. Vetëvlerësimi i ulët mund të jetë shkaktuar nga një sërë faktorësh, dhe mund të jetë një çështje serioze për gratë (dhe meshkuj) të cilët janë viktimat të dhunës në familje.

Në kundërshtim me atë që shumë besojnë, dhuna në familje nuk ka të bëjë vetëm me dhunën fizike. Ajo gjithashtu mund të përfshijë abuzimin seksual, abuzimin emocional, abuzimin financiar, dhe lëndimet. Në thelb, autorë të dhunës në familje gjithmonë ndiejnë se duhet të jenë në kontrollin e viktimave të tyre.

Nëse viktimat e dhunës në familje kanë vetëbesim të ulët, kjo mund t'i bëjë ata të qëndrojnë në një marrëdhënie abuzive. Kjo mund të çojë në dëmtime serioze dhe madje edhe vdekje.

Maria Phelps, një e mbijetuar nga dhuna brutale në familje dhe anëtare e një lëvizje kundër dhunës në familje, vë në dukje: Vetëm vetë-respekti nuk mund të luftojë dhunën në familje. Një grua me vetëbesim të lartë mund të preket nga dhuna në familje, por mendoj se gruaja me vetë-vlerësim të mirë do të jetë më e gatshme për të lënë një marrëdhënie ku ka abuzim dhe kjo është gjë e rëndësishme.

Gratë me vetëbesim të ulët mendojnë se nuk mund të bëjnë më mirë se situata në të cilën ato janë, kjo i bën ato më pak të bindura të largohen se sa një grua që ka vetëbesim të lartë dhe mund të qëndrojë vetëm. Autorë të dhunës në familje kanë tendencë të kenë pre gra që kanë vetëbesim të ulët, kuptojnë se viktimat ka nevojë për të pa marrë parasysh se çfarë bëjnë ata. Për shkak të lidhjes të vetë-respektit dhe dhunës në familje, është e rëndësishme t'i mësojmë fëmijët për vetë-respekt.

Sipas Overcoming.co.uk, një faqe interneti që fokusohet në çështjet e shëndetit mendor, “Përvojat e rëndësishme që ndihmojnë për të formuar vetë-besimin tonë shpesh (edhe pse jo gjithmonë) ndodhin në fillim të jetës.” Prandaj është thelbësore që tek fëmijët të futet Koncepti i Vetë-respekt në moshë të re. Me qëllim për të ndihmuar në parandalimin e dhunës në familje në brezat e ardhshëm, fëmijët duhet të kuptojnë se çfarë janë ndjenjat e shëndetshme dhe të mësojnë mënyra pozitive për t'u ndjerë më mirë

për veten e tyre. Alexis A. Moore, themeluesi i “Të mbijetuarit në veprim”, vëren:

Femrat nuk largohen për shkak të frikës dhe vetë-respektit. Shumica e grave, nëse i pyet të thonë të vërtetën, janë të frikësuar. Kjo është një çështje vetë-respekti kryesisht e përbërë nga frika se ato nuk mund të bëjnë pa qëllimet e tyre.

Dhunuesit janë shumë të vetëdijshëm për këtë dhe e përdorin atë në avantazhin e tyre. Nëse një dhunues mendon se partneri i tij ka të drejtë të largohet, ai do të mundohet ta bindë viktimën se ai në fakt e bën nga dashuria për të, më pas i rrëmben diçka për ta kontrolluar dhe dominuar atë. Diçka që mund të jetë e drejta e viktimës për të holla ose privatësi, ose ndonjë të drejtë tjetër. Ai mund t'i thotë viktimës se ajo nuk krahasohet me të, duke shkaktuar tek viktimat mungesë mbrojtjeje dhe frikë. Edhe në qoftë se një viktimë duket sikur nuk ka asgjë tjetër për të humbur, një dhunues ende mund gjejë diçka për ta kontrolluar dhe që zakonisht ka një ndikim të rëndësishëm tek viktimat, duke bërë që ajo të qëndrojë me abuzuesin e saj edhe për pak kohë. Gratë që kanë të bëjnë me dhunën në familje duhet të mbajnë mend se ato nuk janë vetëm. Miqtë dhe familjarët e viktimave duhet t'i sigurojë që ato të mund të dalin nga situata dhe të kenë një jetë normale. Viktimat kanë nevojë për mbështetje që të mund të jetojnë një jetë pa dhunë.

Phelps, e cila ishte goditur për vite nga burri i saj – një mësues dhe një ushtrues i arteve marcialë - e di sa e vështirë është për t'u larguar. Megjithatë, ajo ka një përgjigje për viktimat e dhunës në familje që duan të dinë çfarë duhet të bëjnë:

E vetmja përgjigje për këtë pyetje është të vraposh. Kjo nuk është zgjidhja e drejtë për të qëndruar në një marrëdhënie abuzive. Një viktimë e dhunës në familje duhet të formojë një plan të sigurisë dhe të dalë nga situata në rastin e parë që të mundë.

Çdo viktimë e dhunës në familje duhet të mbajë mend se nuk ka rëndësi sa të vogël dhe të pambrojtur ju bën dhunuesi juaj të ndiheni. Ju keni vlera dhe meritoni të trajtoheni me respekt dhe dinjitet ... ashtu si gjithë të tjerët.



Fushata vazhdon

Projekti: HAPËSIRË PA DHUNË

Me këtë projekt shoqata Unë, Gruaja (UG) synon të ndërjegjësojë komunitetin se dhuna në familje është një shkelje e të drejtave të njeriut dhe të forcojë përpjekjet e individëve dhe komunitetit për të ndihmuar viktimat e dhunës në familje. Gjithashtu ajo synon të rrisë ndërjegjësimin për dhunën në familje dhe ligjin që e mbron gruan nga dhuna në familje. Për të realizuar këtë synim, shumë aktivitete ndërjegjësuere në bashkëpunim me aktorë të tjerë lokalë, do të zhvillohen gjatë fushatës Nderkombëtare 16 Ditë Aktivizëm Kundër Dhunës Gjinore¹.

Nëpërmjet këtij projekti ne do të përdorim grupin e Task Forcës² i cili është trajnuar mbi këshillimin nëpërmjet projektit “Duna në familje ndalon këtu” të financuar nga Peace Corp. Do të përzgjidhen personat më aktivë të këtij grupi dhe do të angazhohen në organizimin e aktiviteteve dhe workshopeve.

Gjatë fushatës do të organizohet një konkurs në zhanre të ndryshme si: Ese, pikurë, fotografi, video, poezi etj. Ky konkurs do të jetë i hapur për të gjithë komunitetin dhe pjesëmarrësit mund të konkurojnë në të. Punimet më të mira do të botohen në formën e një libri dhe do të shpërndahen ndërmjet target grupit. Do të përzgjidhen dhjetë punimet më të mira dhe fituesit do të shpërblehen me një certifikatë dhe një pagesë simbolike. Nëpërmjet këtij aktiviteti, ne synojmë të nxitisim tek të rinjtë

ndjenjën e barazisë gjinore dhe t’ju japë mundësi atyre të reflektojnë për këtë çështje. Qëllimi i këtij aktiviteti është rritja e nderjegjësimit rreth dhunës gjinore si një çështje e të drejtave njerezore në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Ky projekt do të aktivizojë gra dhe vajza të cilat janë trajnuar dhe edukuar për çështjet e gruas dhe dhunën në familje si dhe të organizojnë takime në shkolla, universitetin Fan Noli në Korçë dhe Pogradec si dhe në komunitet. Ne duam t’u japim mundësi këtyre individëve të trajnuar të tregojnë aftësitë e tyre dhe të praktikojnë njohuritë që kanë marrë gjatë trajnimeve të projektit “Dhuna në familje ndalon këtu”. Këta persona do të angazhohen për të realizuar takime me komunitetin, takime nëpër shkolla dhe universitete. Shumë aktivitete do të organizohen gjatë fushatës ndërkombëtare 16 dite aktivizëm kundër dhunës gjinore.

Gjatë kësaj fushate do të realizohen takime me bashkëpunëtorët dhe me të gjithë aktorët që punojnë për çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës në familje. Do të angazhohen vullnetarë, pika kontakti, mësues, nxënës në shpërndarjen e materialeve publicitare, në ngjitjen e posterave si dhe në organizimin e takimeve me komunitetin. Një vëmendje të veçantë do të ketë dhe publiciteti/fushata mediatike që do të zhvillohet gjatë këtyre ditëve. Të gjitha materialet publicitare që do të

krijohen do të hidhen në faqen zyrtare të website, në faqen e facebook-ut të UG si dhe në faqen zyrtare të organizatës Center for Women’s Global Leadership-16 days of activism (<http://16dayscswgl.rutgers.edu/campaign-calendar>), si dhe në faqen ndërkombëtare të website Say No-UNiTE! <http://www.saynotoviolence.org/say-no-around-world>). Po ashtu do të botohen njoftime në gazetën lokale si dhe në televizionet lokale. Për të përmbyllur fushatën 16 ditë aktivizëm, stafi i UG do të organizojë një aktivitet përmbyllës, ku do të jenë të ftuar të gjithë personat e përfshirë në projekt, të gjithë bashkëpunëtorët si edhe fituesit e konkursit.

Nevoja për këtë projekt lindi nga ballafaqimi me realitetin në shoqërinë tonë. Shqipëria është një shoqëri patriarkale. Gratë nuk i njohin të drejtat e tyre në shoqëri. Gratë nuk dinë të përfitojnë nga ligji dhe të mbrojnë të drejtat e tyre nëpërmjet tij. Ata ose ato që pësojnë dhunë në familje, mund të ndihen të frikësuar, të pasigurt e të inatosur. Dhuna në familje shkakton frikë dhe ul vetëvlerësimin që njeriu ka për veten. Viktimat mund të fajësojnë veten dhe të mendojnë se është faji i tyre. Shpesh gratë nuk kërkojnë ndihmë, sepse u vjen turp të flasin për atë që po ju ndodh. Viktimat mund të mos jenë në gjendje të bëjnë asgjë të paralizohen nga frika. Nganjëherë viktimat nuk flasin, sepse shpresojnë që dhuna do ndalojë.

Shumë kanë frikë se po të ikin abuzuesi i tyre do të përpiqet t’i gjejë dhe do t’i dëmtojë më keq. Shumë shqetësohen se do të humbasin kujdestarinë e fëmijëve apo edhe nuk do t’i shohin më fëmijët e tyre. Një tjetër realitet që shohim në zonën tonë duke ju referuar raporteve të regjistruara nga Data Collection System rezulton se dhuna kundër gruas ende vazhdon të jetë një fenomen i zakonshëm për shoqërinë tonë.

Nëpërmjet këtij projekti ne synojmë të informojmë komunitetin mbi ligjin nr. 9669 “Për masat në marrëdhëniet familiare” dhe ligjin nr. 9670 “Për barazinë gjinore” dhe ta bëjmë atë sa më sensitiv ndaj këtij fenomeni shoqëror.

¹ 16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës Gjinore është një fushatë ndërkombëtare me origjinë nga Instituti i parë Global i Grave në Lidërsip. “16 Ditët e Aktivizmit” është bërë një aktivitet i vazhdueshëm për UG, që nga viti 2009. Me këtë projekt UG, do të përfshijë vullnetarë dhe të rinjtë e shkollave të mesme dhe fillore, për të organizuar aktivitete për fushatën.

² Nëpërmjet granteve SPA (Small Project Assistance) financuar nga Peace Corp, UG ka kryer 12 seanca trainimi gjatë muajve Nëntor 2010 - Prill 2011. Target grupi ishin 30 gra të reja që kishin mbaruar studimet në shkencat shoqërore. Ato morën njohuri mbi këshillimin emocional të viktimave të dhunës, si dhe kanë qenë të përfshirë si vullnetarë në aktivitetet tona. Ne e quajmë këtë grup Task Force. Aktualisht 15 personat më aktive, duke përfshirë dhe personat e kontaktit, mbështetjen e projektit “Forcimi i ofrimit të shërbimeve për të mbijetuarit e dhunës gjinore në Shqipëri” i mbështetur nga Fondacioni SOROS, janë duke ofruar këshillim në telefon si dhe organizojnë takime me komunitetin. Ky grup do të vazhdojë të punojë me UG dhe do të organizojë aktivitetet e parashikuara në këtë projekt.

Njoftim

Shoqata “Unë, Gruaja” me mbështetjen e Korpusit të Paqes shpall konkursin me titull: “Nga paqja në shtëpi, tek paqja në botë- T’i japim fund dhunës ndaj gruas”. Pjesëmarrësit janë të ftuar të shprehin idetë e tyre në këto zhanre: ese, pikurë, video, fotografi, etj. Punimet tuaja mund t’i sillni në adresën: Shoqata Unë, Gruaja, Rr. Rreshit Çollaku, Lgj.1 ose me email: une_gruaja@yahoo.com ose në facebook.

Çmimet për 10 krijimet më të mira do të shpallen në datën 8 Mars në TV Sot7, Gazetën Nositi dhe faqen e facebook-ut të shoqatës.

Ceremonia e përmbylljes do të zhvillohet më 23 Prill, Ditën Botërore të Librit.

Fituesit do të marrin dhuratë një set me libra dhe një



shpërblim monetar. Ftojme biznese nga rajoni ynë, individë apo institucione të ndryshme të kontribuojnë me sponsorizime për zhvillimin e këtij konkursi.

Për më shumë informacion, të interesuarit mund të kontaktojnë në tel. 222140

Ejani me krijimet tuaja deri në fund të shkurtit, s’ka kufizim moshe dhe gjinie!

Ju kujtojmë se Shkurti ka 29 ditë!

Jeni të mirëpritur,
Shoqata Unë, Gruaja
Pogradec

Nëse goditeni apo lëndoheni nga bashkëshorti apo i dashuri juaj kontaktoni shoqatën "Unë, Gruaja". Ajo ju ofron gjithë informacionin për dhunën në familje.

Miliona femra në botë përjetojnë dhunë në familje ashtu si edhe ju. Edhe pse zakonisht është i fshehur, ky lloj abuzimi është i zakonshëm dhe prek njerëz të niveleve të ndryshme shoqërore si psh: mësues, njerëz të famshëm, bankierë, marangozë, shoferë autobuzi.

Asnjë gjë që ju thoni apo bëni nuk është arsye që bashkëshorti apo i dashuri juaj të ushtrojë dhunë drejt jush dhe është e pamundur për ju që ta pengoni këtë dhunë duke u bërë gruaja apo e dashura perfekte. Disa burra mendojnë se përdorimi i dhunës është mënyra më e mirë për t'i zgjidhur problemet dhe është mirë të godasësh një grua. Por askush nuk ka të drejtë t'ju lëndojë fizikisht. Kjo lloj sjellje është kundër ligjit.

Dhuna në familje nuk eliminohet vetë. Tenton të bëhet më keq me kalimin e kohës dhe gjithmonë është e dëmshme për fëmijët.

Fol me një mik ose besoji dikujt atë që po ndodh. Ata mund të jenë një burim i mirë mbështetjeje.

Kontakttoni me programin tuaj lokal të dhunës në familje për të mësuar rreth ligjeve dhe resurseve ekzistuese lokale, si psh: strehëzat, qendrat e këshillimit për gratë, asistencë ligjore për gratë, para se të keni nevojë për to. Ata mund t'ju

ndihmojnë të planifikoni mënyra për të qenë të sigurt.

Kërkojini mjekut të familjes ose një mik të bëmë foto të lëndimeve si psh: (shenja të goditjeve, gërvishtjet, sytë e nxira, etj.) dhe sigurohuni që po i vendosin së bashku me të dhënat mjekësore, ose në një vend të sigurtë me përshkrimin e asaj që ka ndodhur. Ky informacion do t'ua bëmë më të lehtë nëse vendosni të kërkonti mbrojtje ligjore në të ardhmen, siç janë marrja e Urdhrit të Mbrojtjes, masa penale detyruese, marrjen e mbrojtjes së fëmijëve nëse keni nevojë ta bëni këtë.

Caktoni sinjal me komshinjtë që të mund të kuptojnë kur keni nevojë siç mund të jetë, ndezja e një drite gjatë ditës ose mbyllja e një grille, etj.

Mbani disa para mënjanë në një vend të fshehtë që të mund t'i përdorni në rast emergjence, ose në qoftë se vendosni të largoheni, sigurohuni që të keni disa monedha që të mund të bëni telefonata nga telefona publikë nëse keni nevojë. Ju gjithashtu mund të paktoni disa rroba të përditshme dhe objekte të kujdesit personal, dhe një set me syze ose dokumenta ligjore të rëndësishme

për vete dhe për fëmijët, të kërkonti një komshi ose një mik t'i marrë ato bashkë me një set çelësash ekstra në qoftë se do t'ju duhet të largoheni me shpejtësi.

Telefono (83) 22 21 40 në qoftë se je në rrezik ose keni nevojë për ndihmë.

Në qoftë se vendosni të largoheni merrni dokumentet e rëndësishme me vete, si psh: certifikatën e lindjes, pasaportën, dokumentet e sigurimit shëndetësor, foto, lejen e drejtimit të automjetit, të dhëna të tjera, bllok çeqesh, dokumente të ndihmës ekonomike për ju dhe fëmijët tuaj.



Nëse abuzoheni në shtëpi...

Nuk jeni vetëm!

NUK

ka

justifikim për

dhunën në familje!



Njoftim

Nëse jeni duke përjetuar një situatë të dhunës në familje, tani ligji ju ndihmon!

Telefono 22 21 40

Këshillim për gratë e vajzat! Ofrojmë mbështetje emocionale!

Ju informojmë për ligjin "Masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare".

Nga e hëna në të premte, ora 9.30-16.00

Shoqata "Unë, Gruaja", Pogradec



25 Vendlor

25 Vendlor
25 Vendlor
25 Vendlor

1000 hjetor

1000 hjetor
1000 hjetor
1000 hjetor

Te drejtat e

Gruas te jete te

Me te drejtat e

GRUAS

BARABARTA

BURRIT



Ti themi bashkë

JO

LINES

PO

HURISE

Meqenese qe shprehet tek qytetet e tona

Oligeri, i lirë në shpirt dhe në mendje, vazhdon të krijojë

Rruga e jetës

Worcester, Massachusetts. Një 29 vjeçar shqiptar ka hapur ekspozitën e parë vetjake në pikturë. Kjo ekspozitë nuk është vetëm e para e tij, por e para e këtij lloji nga një shqiptar, në këtë qytet që ka një komunitet të madh shqiptarësh.



Jemi mësuar të dëgjojmë për histori suksesi të shqiptarëve të diasporës në fusha të ndryshme, por në mënyrë të veçantë në biznes, e kur shikon një shqiptar që hap një ekspozitë pikturë menjëherë kënaqësia është e dyfishtë.

I riu shqiptar quhet Oliger Merko dhe vjen nga qyteti i Pogradecit. Në Pogradec ka mbaruar shkollën e mesme dhe ka emigruar bashkë me familjen në Amerikë për një jetë më të mirë dhe me më shumë mundësi. Ka studiuar për violonçelo dhe e ka pasur shumë për zemër muzikën, por thirrja e lartë apo pasioni i vërtetë i tij është piktura.

Punimet e tij janë në vaj dhe pastel, ku spikasin portretet, pejzazhet, natyra e qetë... Në punimet e tij dallohen portrete miqsh, njerëz të familjes dhe pejzazhe të natyrës nga vendlindja e tij. Ka mbi 70 piktura ku bie në sy e gjyshja, e ëma, vetëvetja, shtëpia e fëmijërisë në Pogradec, liqeni, festa e rrushit një karakteristike e Pogradecit.

Të gjitha punimet janë krijuar në burg, ku ai vuan një dënim prej vitesh, dhe vazhdon betejën për drejtësi. Piktura është rruga e tij e jetës së re dhe disa nga punimet e tij janë në reflektim me realitetin e

jetës. Këto punime të bukura që pasqyrojnë shumë pasion dhe dashuri, vërtetojnë se artisti është gjithmonë i lirë pavarësisht se ku ndodhet. Fuqia e mendimit dhe e imagjinatës së tij e derdhur në pikturë nuk ngujohet në asnjë moment. I lirë në shpirt dhe në mendje ai vazhdon të krijojë.

Punimet e tij janë shumë të këndshme dhe të japin një afrimitet të madh. Në çdo pikturë ka emocion dhe një histori. Puna e Oligerit është si një ngjarje në vazhdim apo një roman që çdo pikturë tregon një kapitull. Shumë lehtë dallohet influenca e liqenit të Pogradecit, veçanërisht bregu i liqenit.

Në vitin 2010 ka marrë çmimin e parë në konkursin e universitetit të Detroitit me pikturën e tij "Evening Bathers". Oligeri vjen nga një familje artistësh. E gjithë familja është marrë me muzikë dhe në mënyrë të veçantë i ati, Dani. Ai ka mbaruar Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë dhe ka qenë udhëheqës e pjesëmarrës në shumë aktivitete kulturore, gjë që ka influencuar shpirtin artistik tek i biri.

Komuniteti Shqiptar në Massachusetts është po aq i vjetër sa vetë shteti shqiptar dhe është një ndër diasporat e përparuara shqiptare në fushat e ndryshme të

jetës. Me këtë ekspozitë piktori Oliger Merko hap një rrugë për artistët dhe të apasionuarit pas artit të pikturës. Ai guxon dhe provon që një komunitet ka arritur në një shkallë më të zhvilluar kur anëtarët e tij merren me art. Hap një rrugë tjetër për adoleshentët e komunitetit që janë të talentuar dhe ëndërrojnë artin. Me këtë ekspozitë që e ka titulluar "Rruga e jetës", ai hap një dritë jeshile për brezat e rinj në fushën e artit për komunitetin shqiptar në Worcester dhe Massachusetts.

Ekspozita do jetë e hapur për

dy javë, dhe do të shoqërohet me një mbrëmje gala më datën 28 dhjetor, ku pritet të marrin pjesë anëtarë të komunitetit shqiptar, të pushtetit lokal dhe artistë të qytetit. Pikturat e tij janë joshëse, të këndshme dhe ngacmuese. Ngjyrat janë të bollshme dhe të dashura.

Duke shpresuar që rruga e jetës së tij të jetë e gjatë dhe me plot piktura të suksesshme, i urojmë piktorit të ri rrugë të mbarë, në artin e tij të bukur të pikturës!

ARDIAN PREÇI



NJË SHËNDET dhe imunitet i mirë do të ishte një garanci për të mos u sëmurur lehtë nga kjo sëmundje

Laringiti akut

Dr. Andrea Kocaqi*



Të gjithëve, besoj, na ka qëlluar të kemi kaluar një ngjirje të zërit. E kjo gjëndje do të identifikohet si pezmatimi i laringut, ose në gjuhën mjekësore si laringiti.

Duke iu referuar të dhënave klinike vërejmë se laringiti është një sëmundje, por dhe një komplikacion i sëmundjeve të tjera, relativisht i shpeshtë, madje më i shpeshtë në stinët e ftohta të vitit dhe me luhatje të forta e të shpejta të temperaturave. Në këtë kontekst bëhet fjalë për laringitin akut i cili shkaktohet nga ftohja e organit të të folurit, nga viruset ku hera herës mbivendosen edhe infeksione bakteriale të shkaktuara kryesisht nga pneumokoku, hemofilus influence, etj.

Në fakt egzistojnë edhe laringite të tjera si ai i shkaktuar nga tejlodhja e kordave të zërit, nga alergjitë e ndryshme dhe nga sëmundje të tjera por dhe si komplikacion i rinitit, sinuzitit faringitit etj. Por për momentin dhe për stinën që po kalojmë është me interes të ndalem tek laringiti akut. Pra laringiti akut mund të shkaktohet si rezultat i pezmatimit të laringut prej viruseve gripale dhe paragripale, por edhe si pasojë e komplikacionit të tyre për shkak të mbivendosjes së një infeksioni tjetër bakterial. Në këto raste nga

ana klinike fyti konstatohet i përskuqur, kordat vokale po ashtu të skuqura, të enjtura, e që qëndrojnë larg njëra tjetrës. Për pasojë kordat vokale e humbin elasticitetin e tyre dhe një pjesë e ajrit del lirshëm dhe pa realizuar funksjonin e saj, krijimin e tigullit. Kjo gjëndje e ka shfaqjen e saj me ngjirje të zërit, lodhje tej mase gjatë të folurit, tharje të fytit, kollë të ngjirur, (kollë lehëse), e deri në zhdukje pothuajse të plotë të zërit. Nga ana tjetër mund të kemi edhe prezencën e temperaturës që mund të variojë sipas gravitetit të gjendjes së sëmundshmërisë dhe një gjëndje të përgjithshme të komprometuar. Të gjitha këto simptoma janë shumë shqetësuese për një adult, por mendoni çfarë ndodh me fëmijët që hapësirën laringeale e kanë disa herë më të vogël, bllokimi total mund të ndodhë nga çasti në çast.

Përsa i përket mjekimit të laringitit akut, atë do ta vendosë mjeku i familjes. Për këtë arsye ju rekomandoj që me të konstatuar shenjat fillestare të tij menjëherë të drejtoheni për ndihmë mjekësore e të mos e lini sëmundjen të thellohet pasi do të jetë më vështirë për t'u shëruar. Gjithësesi mjekimi konsiston në dhënien e një kortizoniku, në rast se laringiti është i pa komplikuar nga ndonjë infeksion tjetër. Më të përdorshmit në këto raste është ultrakorteni ose

prednizoloni, (me injeksjon), për të paktën për tri ditë. Në rast se kemi edhe mbivendosje të një infeksioni tjetër, përveç kortizonikëve është e nevojshme edhe përdorimi i një antibiotiku, që nga eksperiencia klinike ato të grupit të ceporines kanë rezultuar më të efektshme. Për asnjë arsye nuk duhet lënë pas dore dhe aplikimi i avujve për inhalacion me medikamente shkencore apo popullore, si dhe përdorimi i lëngjeve të ngrohta, (e theksoj të ngrohta e jo të nxehta).

Natyrisht qëndrimi në shtëpi në regjim shtrati, duke evituar kështu ajrin e ftohtë e të lagësht të mëngjesit do të ishte një masë tjetër për një shërim sa më të shpejtë. Parandalimi i laringitit akut nuk ndryshon shumë nga ai i sëmundjeve të tjera të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes që i kam shtjelluar në artikuj të tjerë. Paraprakisht një shëndet dhe imunitet i mirë do të ishte një garanci për të mos u sëmurur lehtë nga kjo sëmundje. Pra kalitja fizike në natyrë, me ajrin e pastër ujin e freskët dhe konsumimi i ushqimeve bio, do t'ju mbante larg sëmundjeve të aparatit të frymëmarrjes e për pasojë edhe ndaj laringitit akut. Gjithashtu është e nevojshme të jeni të vëmendshëm në veshjet të përshtatshme në stinët me

ndryshime të forta dhe të shpeshta të temperaturave dhe me prezencën e tepërt të lagështisë. Përdorimi i shallit apo i një shamie përpara hundës e gojës në kohë me mjegull është gjithmonë e këshillueshme. Në këto stinë janë të shpeshta rastet me grip, kështu që lipset të zbatoni të gjitha rregullat e përcaktuara për mbrojtjen kundër gripit për të evituar mundësinë e komplikimit të tij me laringitin.

Një kujdes akoma më të madh duhet të tregojnë në këtë kohë personat që vuajnë me sëmundje të tjera të aparatit të frymëmarrjes, me laringit kronik si dhe ata me imunitet të dobët. Së fundi do të theksoj edhe një herë se nëse vëreni shenjat më të vogla e më fillestare të laringitit drejtoheni menjëherë tek profesionistët për të marrë mjekimin dhe këshillat e duhura, për një shërim sa më të shpejtë e që laringiti të mos mbetet kronik.

* Mjek p./f. Ambulanca Libonik - Korçë



Në kryet e saj kish thurur një kurorë me ato pak fije bari që la lufta pas dhe zjarri

Intervistë e dr. Misto Markos dhënë në 19 dhjetor 1988 me rastin e vënies së emrit "Lasgush Poradeci" Pallatit të Kulturës së qytetit

Marjeta, ke shumë të drejtë, se me këtë të ftohtë ne justifikojmë ata shokë që nuk erdhën, të cilët do të kishin dëshirë të madhe të vinin, të ishin midis nesh. Edhe Lasgushin ne e bindnim me zor në kësi të ftohtash ta shpjemë në ndonjë mbledhje. Se edhe ay ishte i moshuar. Unë do të kujtoj këtu një takim me shkrimtarët grekë, me Rita Bumi Papan dhe të shoqin e saj Niko Papas. Një pasdite më vjen e më troket në derë aty nga ora 3 Lllazar Siliqi. I thom të hyj në shtëpi: -Jo, -thotë -se kam një punë me ngut, vetëm të më sjellësh në orën 6 Lasgushin se ka ardhur Rita Bumi Papa.

Vetëm emri i Lllazar Siliqit kisha besim se do ta bindte Lasgushin, se kishte një respekt të veçantë për

të. Dhe vajta në shtëpi i thashë Kostandinës, ta veshësh mirë e ta bësh gati, në ora 6 pa njëçerek, Lllazari do vij ne ty. Mirë, më tha, dakort në ora 6 pa një çerek. Vajta në shtëpi dhe bashkë me të u nisëm për në turizëm. Atje arritëm tamam në orën 6 dhe ne shkalla na kishte dalë na priste Lllazar Siliqi me dy miqtë e tij me Rita Bumi Papan, poeteshën e njohur të rezistencës greke dhe Niko Papasin, edhe ay një poet edhe një studiues i madh i letërsisë greke. Lasgushi, nja 4 metro përpara se të arrinim atje, u ndal menjëherë në vend dhe recitoi ashtu siç recitonte bukur ay greqisht.

"Në tokën e shkretuar të Psahasës, zbriti lavdia që të numërojë trimat që ranë dëshmorë.



Në kryet e saj kish thurur një kurorë me ato pak fije bari që la lufta pas dhe zjarri."

Të dy miqtë u befasuan kaq shumë sa zbritën shkallët e muar në qafë Lasgushin.

Të gjithë ato bisedat që bëme me këta dy shkrimtarë mua më kanë mbetur, më kanë lënë mbresa dhe nuk i harroj kurrë. Kaq kisha.

TRASHËGIMI

Ju më lini të flas unë,
T'u them fjalë vjershërije,
Në bunacë a në furtunë
Të këndoju siç më ka hije.

Hija ime nuk di dhunë,
Di veç frymëzim lirije,
Dhe di punë, punë, punë,
Mund pa fund për art magjije.

Që të them nga ç'pata shkruar
Me kuvënd të përvëluar:
Ja! një isker mjeshtërije,
Ja! një isker bukurije.

Dhe t'a shoh të pasqyruar
Vetëveten fije-fije,
Fije-fije poezije,
Që mban erë Shqipërije.

Intervista, fotografitë dhe vizatimet iu dhanë gazetës "Nositi", nga z. Budjon Xhelo.

-poezi-

Bodeler

Një Lutje

*Engjëll shënd e verë, e di
ankthin ti,
Turp, dënesje, e stërmundim-
trishtimi,
Netët plot me tmerr verbim
hidhërimi
Që zemrën t'a djegin si
t'ishte qiri?
Engjëll shënd e verë, ankthi
ç'është' e di?*

*Engjëll gjith-mir'si, di ti nga
tërbimi,
Grushtet fort shtrënguar, lot
e përgjërim,
Hakmarrja lëshon kushtrimin
për zgjim,
Trup e shpirt në një u hap
rrug' si trimi?
Engjëll dashamir, di ti ç'është'
tërbimi?*

*Engjëll plot shëndet, di ti
ethet ç'janë,
Murreve pafund t'azilit të
shplarë
Burgaxhinj meitë që tërhiqen
zvarrë,
Një rreze kërkujn', buza iu
rrënqethet
Engjëll plot shëndet, di ti
ç'janë ethet?*

*Engjëll hirëplot, rrudha a ke
parë,
Frikën-tmerr nga mplakja,
atë zi mundimi
Të lexosh në sy ankh
sakrifikimi
N'sytë pa të cilët nuk do rroje
dot!
Di ti rrudhat ç'janë, engjëll
hirëplot?*

*Engjëll mirësie, gëzim e
ndriçim,
Davidi n'lëngim shëndet do
kërkonte
Nga ky trupi yt që magji
lëshonte;
Veç lutjen t'kërkoj, të vetmin
shërbim,
Engjëll mirësie, gëzim e
ndriçim!*

Përktheu: Ilir Fico, piktor



Mundësi për të rinjtë!

Në kuadër të Projektit “Ndërgjegjësohu - Monitoro - Vepro” financuar nga Ambasada Amerikane

Janë të ftuar të aplikojnë vajza dhe djem për të monitoruar Këshillin Bashkiak Pogradec. Qëllimi i këtij projekti është të rrisë ndërgjegjësimin e komunitetit, shoqërisë civile, anëtarëve të këshilit bashkiak dhe medias për t'u bërë pjesëmarrës aktivë në vendimmarrje.

Mund të sillni CV-të tuaja pranë shoqatës "Unë, Gruaja" në adresën Rr. Rreshit Çollaku. Pogradec; ose e-mail: une_gruaja@yahoo.com. Afati për dorëzimin e CV-ve është deri më datë 20 dhjetor 2011.

Për më shumë informacion kontaktoni në numrin e telefonit 083 222- 140

Jeni të mirëpritur!



Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias

THIRRJE PËR ESE
RRETH TEMËS SË INTEGRIMIT EUROPIAN



EUROPA, JO EUROTOPIA: NJË FTESË PËR DEBAT

Instituti Shqiptar i Medias, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, fton gazetarët dhe opinionistët e medias që të marrin pjesë në debatin “Europa, jo Eurotopia,” duke paraqitur ese rreth temës së integrimit evropian të Shqipërisë. Duke qenë se viti 2012 do të jetë një vit vendimtar në rrugën e Shqipërisë drejt BE, pjesëmarrësit janë të ftuar që të shprehin opinionet e tyre rreth pyetjeve: “Ku jemi në procesin e integrimit evropian? Pse jemi vonuar? Çfarë duhet bërë për ta përshpejtuar procesin? Cilat janë pengesat që duhet të kapërcejmë? Ku jemi në krahasim me fqinjët? Cilat janë perceptimet e publikut rreth integrimit evropian? Cili është roli i shoqërisë civile në këtë proces?”

Pjesëmarrësit ftohen të paraqesin opinionet e tyre në ese jo më të gjata se 2000 fjalë. Esetë do të botohen fillimisht në një portal/link të website-it të Institutit Shqiptar të Medias dhe më pas

do t'u jepen gazetave kryesore që mund t'i botojnë në përputhje me politikën e tyre editoriale. Esetë mund të dërgohen duke filluar nga data 9 janar dhe duke përfunduar më 31 mars në adresën: gimi@institutemedia.org

Pjesëmarrësit duhet të shënojnë në krye të esesë Emrin dhe Mbiemrin, si dhe një numër telefoni ku mund të kontaktohen në rast nevojë.

Esetë që do të botohen do të shpërblehen me një pagesë të arsyeshme.

Instituti Shqiptar i Medias

Rruga Gjin Bue Shpata, Nr 8, Tiranë, Tel/Fax + 355 42 22 98 00

www.institutemedia.org

Botues: Ilir DUKA & Afroviti GUSHO

Gazetarë: Ilir Buzali, Ketrina Mitllari

Korrespondente: Alda Isallari, Albana Maxhari

Lexoni gazetën në: www.poradeci.com

Gazeta shpërndahe në Qarkun Korçë

Enti Botues: "DIJA - Poradeci", -Pogradec

Adresa e Redaksisë: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec

Tel: +355 832 2905, Mobil: 069 2143753

e-mail: afrovitig@yahoo.com